

VENDIM
Nr. 35/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 92/2017,
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË
APELIMIT,” I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës; të neneve 18, pika 1, e 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 55 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, e vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa efektet financiare për përshtatjen e klasave të pagave në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, fillojnë nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT
TË POSAÇËM TË APELIMIT**

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
		(2)
I. KRYETAR	G3*	1
Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit	II-1	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		(6)
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(25)
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	14
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	11
IV. SEKETAR I PËRGJITHSHËM	I-1	1
V.DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(17)
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	8
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	2
Përkthyes	II -1	4
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II -1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(12)
Drejtor	I- 4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	1
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT**	IV-1	2
Specialist protokoll/arkivë***	IV-1	2
Magaznier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/Korrier	V	1
Punonjës mirëmbajtje	III	1
Total		63

Shënim.

** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*